



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 62 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27 / 06 / 2022

VENDIM

Nr.16, date 27 /06/2022

PËR

AKTIN E KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT PËR NDERTIMIN E DIGËS LUMZI

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Neni 24, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 27.06.2022 mori në shqyrtim kërkesën për miratimin e aktit të kolaudimit të punimeve të zbatimit për ndertimin e digës së HEC Lumzi. Gjatë mbledhjes u diskutua në lidhje me problematikat e konstatuara gjatë procesit të kolaudimit të punimeve të kësaj dige sic janë mosplotesimi i kërkesave nga shfrytëzuesi i digës të nenit 21, 24, 25, 30, 32 dhe 35 të VKM Nr. 147 së mësipërme, mungesa e përfaqësuesit të ITD gjatë procesit të kolaudimit të digës, etj.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të mos miratoj aktin e kolaudimit të punimeve të zbatimit për ndertimin e digës së HEC Lumzi.
- 2- Ti kërkoj shfrytëzuesit të digës së HEC Lumzi të marrë masat për zgjidhjen e problematikave të mesiperme dhe të hartoj një raport për gjendjen aktuale të digës, monitorimin dhe Sigurinë e digës ku duhet të përfshihen plani i instrumentimit për monitorimin e digës si dhe plani i gadishmerisë në rastet e emergjencave civile i cili duhet të përfshijë edhe hartën e permbytjeve, llogaritjet e vales verdhuese, skenaret e rasteve të emergjencave sipas udhësimeve të KKDM. Në raport duhet të jepen përveç konkluzioneve për sigurinë e digës edhe masat që do të ndermerren në të ardhmen nga shfrytëzuesi i digës. Raporti duhet të përgatitet nga ekspertët të kualifikuar, të pavarur dhe të licencuar në sektorin e digave të mëdha. Njekohësisht, Ekspertët duhet të përgatitin kurbën e volumeve aktuale të ujit në rezervuar bazuar në matjet e depozitimeve të materialeve të ngurta në përputhje me kërkesat e nenit 30 të VKM së mësipërme. Dokumentat teknike të mësipërme duhet të dorëzohen pranë SKDM brenda muajit Shtator 2022.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

